



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 2/1 Prot.

Tiranë, më 21/3/2011

Lënda: Rekomandim për “**Pelican Security**” sh.p.k

### REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “**Pelican Security**” sh.p.k ,

### KONSTATOVA

Më datë 02..02.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar hetimi administrativ pranë kontrolluesit, “**Pelican Security**” sh.p.k , me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Mbrojtja e të dhënave personale, kriteret ligjore për përpunimin, përpunimi i të dhënave sensitive, transferimi ndërkombëtar i të dhënave të parashikuara në nenet 5,6,7,8,9 të ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.
- Zbatimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave personale.
- Si respektohen kushtet dhe kriteret, parashikimet e ligjit 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale, gjate mbledhjes, përpunimit te të dhënave personale përmes përdorimit te mjeteve, sistemeve vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, etj.
- Plotësimi i detyrimit për njoftim (neni 21).
- Siguria e të dhënave personale, masat e marra për sigurinë e të dhënave personale, (neni 27).

Komisioneri “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” pasi shqyrtoi procesverbalin e hetimit administrativ të mbajtur me këtë rast si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi “ Pelican “ sh.p.k, grumbullon dhe përpunon të dhëna personale vetëm të stafit të ngushtë administrativ dhe respekton kërkesat ligjore të përcaktuara në nenet 5,6,7, 8 dhe 9 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

U konstatua se, ambjentet e brendshme të kontrolluesit ishin të pajisura me sistem kamera vëzhgimi. Pas verifikimeve dhe diskutimeve me kontrolluesin, duke qënë se ky sistem video-survejues, ka gjithë potencialin e mundshëm teknik për të rregjistruar, u sugjerua që në zbatim të nenit 18 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”,...”*Kontrolluesi kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre te dhënave....*” të vendosen tabela informuese në ambientin ku ishte vendosur kamera, gjë të cilën kontrolluesi e zbatoi gjatë procesit hetimor administrativ. Gjithashtu, u konstatua se, sistemi i vëzhgim monitorimit me kamera ishte vendosur në një ambient të mbyllur dhe të aksesueshëm vetëm nga dy punonjës, të drejtat, detyrimet e të cilëve dhe e drejta për akses ishin të përcaktuara qartë në përshkrimin e punë( Job Description) të tyre. Informacioni ruhej për një periudhe 7 ditore në mënyrë të riciklueshme.

Kontrolluesi “ Pelican “ sh.p.k, si një shoqëri sigurimi, ka lidhur kontratë sipërmarrjeje për ruajtje objekti me kontrolluesin “Euromax” sh.p.k.

Për sa i përket aksesit që, Kontrolluesi “ Pelican Security “ (kjo shoqëri sigurimi), ka mbi imazhet e rregjistruara sipas sistemit të kamerave survejuese, tek palët kontraktuese ku ajo ofron shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë,(e drejtë kjo parashikuar nga neni 10/1, Ligji nr.8870, datë 19.04.2001, “Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike”,...”*Shoqëria, për përmbushjen e misionit të vet, ka të drejtë të vendosë mjete ose sisteme vrojtuese, sinjalizuese, audiovizive, pajisje ndërlidhjeje si dhe të përdorë teknika të tjera, duke respektuar legjislacionin në fuqi*”),në kontratën e sipërmarrjes me Kompaninë “Euromax” sh.p.k, u konstatua se, nuk ishte parashikuar nga palët akses vizual që, punonjësi i shërbimit të këtij kontrolluesi, kishte mbi kamerat vëzhguese të Kompanisë “Euromax” sh.p.k. Nga verifikimet në kompaninë “ Euromax” sh.p.k., u konstatua se, ky sistem i kamerave vëzhguese ishte i administruar nga punonjësit e kësaj kompanie por, gjithashtu u konstatua se, punonjësi i shërbimit të “ Pelican Security “ sh.p.k kishte akses vizual në këtë sistem.

Kryesisht, ky ishte akses vizual që do të thotë se ky punonjës ( i “Pelican Security “ Sh.p.k”) nuk kishte të drejtë të administronte të dhënat, por thjesht në rast konstatimi të shkeljeve(vjedhjeve të mundshme) sinjalizonte përfaqësuesit e “ Euromax “ sh.p.k.

Sa më sipër në këtë rast, “ Pelican Security “ përsa i përket të dhënave personale të siguruara nga rregjistrimet e CCTV është përpunues i të dhënave personale sipas përkufizimeve të nenit 3/5 “ *Përpunues është cdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjensi ose cdo njësi tjetër, përvec punonjësve të kontrolluesit, që përpunojnë të dhëna për vetë kontrolluesin* ” të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të dhënave personale”.

Megjithatë, të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me, sistemin e video-surveimit nuk ishin përcaktuar, në asnjë dokument ligjor dhe në asnjë prej pikave të kontratës të sipërmarrjes të lidhur midis palëve.

Kontrolluesi “ Pelican Security “, në kundërshtim të nenit 27/2, në të cilin parashikohet se: “Kontrolluesi merr këto masa të vecanta sigurie :”.....*Udhëzon operatorët, pa përjashtim, për detyrimet që kanë, në përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë edhe rregulloret për sigurinë e të dhënave* “, dhe nenit 28 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, nuk është shprehur në ndonjë rregullore të brendshme të hartuar prej tij, lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin për të dhënat personale.

Pavarësisht faktit se, punonjësi i shërbimit të “Pelican Security”sh.p.k, ka vetëm akses visual në sistemin e kamerave regjistruese të video surveimit të instaluar në ambientet e Kompanisë “EUROMAX” sh.p.k, ky punonjës definohe si “Përpunues i të dhënave”, sipas nenit 3, pika 7, i Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në të cilin parashikohet se :”*Përpunimi i të dhënave është çdo veprim që kryhet plotësisht ose jo me mjete automatike, me të dhënat personale, si grumbullimi, regjistrimi, ruajtja, përdorimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi apo çdo veprim tjetër, si dhe transmetimi i të dhënave*”.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

## REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 te ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, kontrolluesi “ Pelican Security “ sh.p.k të hartojë rregullore të brendshme ose të përfshijë në rregulloren ekzistuese seksionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kofidencialitetin.
2. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 te ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Pelican Security “ sh.p.k, në rastet kur punonjësit e shërbimit të kësaj shoqërie, kanë akses në të dhënat personale që mblidhen nëpërmjet sistemit të video surveimit, në ambientet ku sigurohet shërbimi i

ruajtjes dhe sigurisë fizike, të përcaktojë në një dokument të shkruar ose në marrëveshjen e lidhur midis palëve të drejtat dhe detyrimet e palëve në përpunimin e këtyre të dhënave, në veçanti të shprehet në mënyrë të detajuar kush e ka të drejtën e aksesit, personin e autorizuar për administrimin e CCTV.

3. Në vazhdim të pikës 2, në marrëveshjet e mëtejshme që kontrolluesi “ Pelican Security” sh.p.k, do të ketë, në rast se ky kontrollues do aksesoj të dhënat personale që përpunohen nga palët kontraktuese të tij, jo vetëm nëpërmjet CCTV por, edhe në forma dhe mënyra të tjera, duhet të saktësojë të drejtat dhe detyrimet e palëve në përpunimin e këtyre të dhënave.

Kryerja e këtyre rekomandimeve të rëndësishme për mbrojtjen e të dhënave personale që ju ngarkon ligji të realizohet brenda një afati kohor prej 30 ditësh.

Në rast moszbatimi të këtyre rekomandimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

**KOMISIONERI**

**FLORA CABEJ (POGAÇE)**

